

Vendim nr. 13 datë 15.01.2025

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Fiona Papajorgji,	Kryesuese
Ilir Toska,	Anëtar
Sandër Beci,	Anëtar

në datën 15.01.2025 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 20 (F) 2024 të Regjistrit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: **FATJON KARMESHTNA**, përfaqësuar nga avokat Agim Bega, me prokurë.

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimeve nr. 21, datë 12.03.2019 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të rënda; nr. 48, datë 26.06.2019 të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda; nr. 00-2024-1276, datë 11.07.2024 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 27, 33, 40, 43, 49, pika 3, “shkronja “e”, 50 pika 4, 131, pika 1, shkronja “f”, 134, pika 1, shkronja “i” dhe 142 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 1 dhe 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoji relatorin e çështjes Sandër Beci, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Në datën 18.04.2016 në fshatin Melgushë, Shkodër, në mjediset e brendshme të një njësie biznesi të shtetasit Sa.S. është gjetur e vdekur bashkëshortja e tij Su.S., e cila, në vijim, ka rezultuar se është shkaktuar nga asfiksia mekanike, konkretisht nga shtrëngimi i qafës me duar dhe mjete të tjera rrethanore ndihmëse. Për këtë ngjarje, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, në datën 26.04.2016, ka regjistruar procedimin penal nr. 83, për veprën penale “Vrasja për shkak të marrëdhënieve familjare”, të parashikuar nga neni 79/c i Kodit Penal (*KP*) ndaj bashkëshortit të viktimës. Ky i fundit, në vijim, është akuzuar për këtë veprë penale dhe çështja është dërguar për gjykim.

2. Ndërsa çështja penale ndaj bashkëshortit të viktimës ndodhej në gjykim, po lidhur me ngjarjen e mësipërme, në datën 17.01.2018, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda ka regjistruar procedimin penal nr. 9 për të njëjtën veprë penale, tashmë nën rrethanën rënduese të bashkëpunimit, të parashikuar nga nenet 79/c dhe 25 të *KP*-së, duke shënuar në vijim në regjistrin e njoftimit të veprave penale emrin e kërkuesit, i dyshuar si bashkautor në kryerjen e veprës krahas bashkëshortit të viktimës. Në kuadër të hetimit paraprak të këtij procedimi penal është realizuar edhe marrja e kampionit biologjik të pështymës së kërkuesit dhe, në vijim, një ekspertim biologjik krahasues ADN-je, përmes të cilit nga ekspertët është arritur në përfundimin se midis profilit gjenetik të mbetjeve humane të marra nga thonjtë e dorës së djathtë të viktimës gjatë hetimeve paraprake, në kuadër të procedimit tjetër penal nr. 83/2016, me profilin gjenetik të pështymës së kërkuesit, rezultonte përputhje e plotë. Në vijim, kërkuesi është akuzuar për veprën penale të parashikuar nga nenet 79/c dhe 25 të *KP*-së dhe në datën 04.07.2018 prokuroria i ka kërkuar gjykatës dërgimin për gjyq të çështjes penale në ngarkim të tij. Me vendimin nr. 86, datë 19.07.2018, Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda (gjyqtari i seancës paraprake) ka vendosur kalimin e çështjes për gjykim.

3. Çështja penale ndaj kërkuesit është gjykuar me procedurë të zakonshme dhe në përfundim, Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda, me vendimin nr. 21, datë 12.03.2019,

ka vendosur deklarin e tij fajtor për veprën penale për të cilën akuzohej, duke e dënuar atë me burgim të përjetshëm. Ajo gjykatë, në mënyrë të përmbledhur, ka arsyetuar se në gjykim është provuar kryerja e veprës penale, duke e gjetur të drejtë cilësimin juridik të saj, sipas akuzës, si dhe se autor i saj, përtej çdo dyshimit të arsyeshëm, është edhe kërkuesi, i cili, në marrëveshje dhe me porosi të bashkëshortit të viktimës, ka vepruar në rolin e ekzekutorit në vrasjen e shtetasës Su.S. Kundër këtij vendimi ai ka paraqitur ankim.

4. Gjykata e Apelit për Krime të Rënda, pasi ka përsëritur pjesërisht hetimin gjyqësor me kërkesë të mbrojtësve të kërkuesit, me vendimin nr. 48, datë 26.06.2019, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë. Gjykata e apelit, në mënyrë të përmbledhur, ka arsyetuar se në analizë të provave të shqyrtuara dhe të verifikuara gjatë procesit gjyqësor, përfundimet e gjykatës së shkallës së parë në lidhje me fajësinë e kërkuesit, cilësimin juridik të veprës penale dhe dënimin e caktuar ndaj tij, janë të drejta. Sipas saj, kërkuesit nuk i është shkelur asnjë e drejtë dhe garanci procedurale, ndërkohë që organi i akuzës, përtej çdo dyshimi të arsyeshëm, ka provuar se ai ka kryer veprën penale për të cilën është akuzuar. Kundër këtij vendimi kërkuesi ka paraqitur rekurs nëpërmjet mbrojtësve të tij.

5. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2024-1276, datë 11.07.2024, në dhomën e këshillimit, ka vendosur mospranimin e rekursit të kërkuesit, me arsyetimin se ai nuk ka arritur të argumentojë asnjë shkelje të ligjit material ose procedural penal, në referim të shkaqeve të parashikuara nga neni 432 i Kodit të Procedurës Penale (*KPP*).

6. Në datën 25.10.2024 kërkuesi ka paraqitur ankim kushtetues individual në Gjykatën Kushtetuese (*Gjykata*), sipas objektit të tij, i cili, pasi është plotësuar sipas kërkesave të nenit 27 të ligjit nr. 8577/2000, është regjistruar në datën 12.11.2024.

II

Pretendimet e kërkuesit

7. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se ndaj tij nuk është zhvilluar një proces i rregullt ligjor, në drejtim të:

7.1. *Parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit*, pasi gjykatat e faktit nuk kanë kryer një hetim të plotë dhe të gjithanshëm dhe provat nuk janë vlerësuar për aq vlerë sa kanë sikurse parashikon nenin 152 i KPP-së. Ato nuk i kanë marrë në

konsideratë provat me dëshmitarë të kërkuarit, deklaratimet e bashkëshortes së tij N.B. dhe të shtetasit I.D., që vërtetojnë në mënyrë të pakontestueshme se kërkuari nuk është autor i vrasjes për të cilën akuzohet. Për të njëjtën veprë penale janë akuzuar dy persona dhe megjithëse bashkimi i procedimeve penale ka qenë i domosdoshëm, çështjet ndaj tyre janë gjykuar veç e veç me qëllim për të rënduar pozitën e kërkuarit. Gjykimi i këtij të fundit ka qenë formal pasi ai është deklaruar fajtor pa u dëgjuar në gjykimin tjetër të zhvilluar ndaj bashkëshortit të viktimës. Po kështu, gjykatat, në shkelje të hapur të ligjit, kanë refuzuar kërkesën e mbrojtjes për kryerjen e riekspertimit biologjik në lidhje me ADN-në e viktimës dhe të kërkuarit nga një institucion ndërkombëtar, në kushtet e mungesës së besueshmërisë ndaj aktit të ekspertimit të realizuar nga një institucion në varësi të Ministrisë së Brendshme, si dhe kur materiali për nxjerrjen e profilit gjenetik të kërkuarit është marrë në rrugë operative. Gjithashtu, gjykatat nuk kanë administruar një provë dominuese, siç është informacioni për vendndodhjen e qelizës telefonike të aparatit të kërkuarit dhe lëvizjet e tij ditën e ngjarjes. Për pasojë, në rastin e kërkuarit, nuk është ndërtuar një raport i drejtë midis provave të sjella nga organi i akuzës me provat e paraqitura nga ana e mbrojtjes së tij, ndërsa ai është dënuar pa u provuar kryerja e ndonjë veprimi konkret në lidhje me veprën penale për të cilën akuzohet.

- 7.2. *Standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor*, pasi gjykatat e faktit kanë krijuar bindjen në prova imagjinare dhe jo në formën e kërkuar nga ligji. Konkluzionet e nxjerra nga ato nuk përshkruajnë mekanizimin e ngjarjes dhe se si është kryer vepra penale për të cilën kërkuari është akuzuar dhe dënuar. Vendimet e atyre gjykatave janë produkt i shkeljeve të rënda procedurale, të cilat kanë ndikuar drejtpërdrejt në dhënien e vendimit, por edhe në zbatim të gabuar të ligjit penal. Pavarësisht kësaj, Gjykata e Lartë nuk ka përmbushur funksionin e saj për të vlerësuar gabimet në fakt të gjykatave më të ulëta, pra bazueshmërinë në prova të vendimeve të tyre dhe, më tej, zbatimin e gabuar të ligjit penal nga ato.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. *Për legjitimitimin e kërkuarit*

8. Çështja e legjitimitetit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

9. Kërkuesi, si individ legjitimohet *ratione personae*, bazuar në nenet 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, pasi ka qenë palë në procesin gjyqësor ndaj të cilit ka ngritur pretendime në këtë Gjykatë dhe ka interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar.

10. Në lidhje me kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, kërkuesi i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual pas përfundimit të procesit gjyqësor në të tria shkallët e gjyqësorit të zakonshëm dhe pasi ka shteruar në formë e substancë mjetet e zakonshme të ankimit ndaj vendimeve të gjykatave më të ulëta.

11. Lidhur me legjitimitetin *ratione temporis*, në kuptim të përmbajtjes së nenit 71/a, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577/2000, Kolegji konstaton se vendimi më i fundit në kohë i kundërshtuar, ai i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, mban datën 11.07.2024, ndërsa ankimi kushtetues individual është paraqitur në datën 25.10.2024, pra brenda afatit ligjor 4-mujor.

12. Në lidhje me legjitimitetin *ratione materiae*, kërkuesi ka pretenduar cenimin e parimit *barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit*, si dhe *standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor*. Nisur nga thelbi i argumenteve të kërkuesit, Kolegji vëren se ato janë të lidhura e të ndërvarura nga njëra tjetra, ndaj vlerëson që pretendime e tij t’i analizojë në vijim të lidhura mes tyre.

B. Për pretendimin e cenimit të parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit të lidhur me standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor

13. Kërkuesi ka pretenduar se gjykatat e faktit nuk kanë kryer një hetim të plotë dhe të gjithanshëm dhe provat nuk janë vlerësuar për aq vlerë sa kanë sikurse parashikon neni 152 i

KPP-së. Sipas kërkuesit, gjykatat nuk i kanë marrë në konsideratë provat e tij me dëshmitarë, të cilat vërtetojnë në mënyrë të pakontestueshme se ai nuk është autor i vrasjes për të cilën akuzohet. Po sipas tij, për të njëjtën vepër penale janë akuzuar dy persona dhe megjithëse bashkimi i procedimeve penale ka qenë i domosdoshëm, çështjet ndaj tyre janë gjykuar veç e veç me qëllim rëndimin e pozitës së tij, ndërsa gjykimi për të ka qenë formal pasi ai është deklaruar fajtor pa u dëgjuar në gjykimin tjetër të zhvilluar ndaj bashkëshortit të viktimës. Gjykatat, sipas kërkuesit, në shkelje të hapur të ligjit, kanë refuzuar kërkesën e mbrojtjes për kryerjen e riekspertimit biologjik në lidhje me ADN-në e viktimës dhe të kërkuesit nga një institucion ndërkombëtar, në kushtet e mungesës së besueshmërisë ndaj institucionit (në varësi të Ministrisë së Brendshme) që ka realizuar aktin e ekspertimit, si dhe kryerjen e këtij akti mbështetur në një material për nxjerrjen e profilit gjenetik të tij të marrë në rrugë operative. Gjykatat, vijon kërkuesi, nuk kanë administruar një provë dominuese siç është informacioni për vendndodhjen e qelizës telefonike të aparatit të tij dhe lëvizjet që ka bërë ditën e ngjarjes. Për pasojë, në rastin e tij, nuk është ndërtuar një raport i drejtë midis provave të sjella nga organi i akuzës me provat e paraqitura nga mbrojtja e tij, ndërsa ai është dënuar pa u provuar kryerja e ndonjë veprimi konkret. Po kështu, sipas kërkuesit, gjykatat e faktit kanë krijuar bindjen mbi prova imagjinare dhe jo në formën e kërkuar nga ligji, ndërkohë që konkluzionet e nxjerra nga ato nuk përshkruajnë mekanizimin e ngjarjes dhe se si është kryer vepra penale për të cilën ai është akuzuar e dënuar. Vendimet e atyre gjykatave janë produkt i shkeljeve të rënda procedurale, të cilat kanë ndikuar drejtpërsëdrejti në dhënien e vendimit, por edhe në zbatimin e gabuar të ligjit penal. Pavarësisht kësaj, sipas kërkuesit, Gjykata e Lartë nuk ka përmbushur funksionin e saj për të vlerësuar gabimet në fakt të gjykatave më të ulëta, pra bazueshmërinë në prova të vendimeve të tyre dhe, më tej, zbatimin e gabuar të ligjit penal nga ato.

14. Sipas nenit 42 të Kushtetutës, të drejtat e njohura me Kushtetutë dhe me ligj nuk mund të cenohen pa një proces të rregullt ligjor dhe kushdo në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë. Ndërsa sipas 31, shkronja “d” të saj, gjatë procesit penal kushdo ka të drejtë t’u bëjë pyetje dëshmitarëve të pranishëm dhe të kërkojë paraqitjen e dëshmitarëve, të ekspertëve dhe të personave të tjerë, të cilët mund të sqarojnë faktet. Neni 32, pika 2, i Kushtetutës përcakton se askush nuk mund të deklarohet fajtor mbi bazën e të dhënave të mbledhura në mënyrë të paligjshme. Kurse neni 142, pika 1, i saj, parashikon se vendimet gjyqësore duhet të jenë të arsyetuara.

15. Në jurisprudencën e saj, Gjykata ka theksuar se veçanërisht në procesin penal, barazia e armëve dhe kontradiktoriteti përbëjnë në vetvete ndër elementet më thelbësore të procesit të rregullt ligjor në kuptimin kushtetues, ndaj për respektimin e këtij parimi gjykatat e juridiksionit të zakonshëm duhet të përmbushin një sërë detyrimesh, mes të cilave edhe realizimin e një debati real ndërmjet akuzës dhe mbrojtjes, çka ndikon në mënyrë të drejtpërdrejtë në zbulimin e së vërtetës dhe dhënien e drejtësisë nga gjykata (*shih vendimet nr. 35, datë 01.06.2015; nr. 23, datë 23.07.2009; nr. 16, datë 08.06.2006 të Gjykatës Kushtetuese*). Në lidhje me mënyrën e marrjes së provave, Gjykata është shprehur se ajo ka rëndësi thelbësore për zhvillimin e drejtë të procesit penal. Gjykatat e kanë për detyrë të vlerësojnë në tërësi nëse procedurat lidhur me mënyrën se si janë siguruar provat kanë qenë të drejta (*shih vendimet nr. 67, datë 10.11.2017; nr. 7, datë 27.04.2005; nr. 95, datë 27.07.2001 të Gjykatës Kushtetuese*). Në gjykim provat merren me kërkesën e palëve dhe një provë nuk mund të përdoret kur është marrë në shkelje të ndalimeve të parashikuara nga ligji. Çdo provë i nënshtrohet shqyrtimit e nuk ka vlerë të paracaktuar dhe gjykata i vlerëson ato sipas bindjes së formuar pas shqyrtimit të tyre në tërësi (*shih vendimet nr. 8, datë 19.03.2018; nr. 9, datë 26.02.2015; nr. 7, datë 27.04.2005 të Gjykatës Kushtetuese*).

16. Për sa i përket standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor, Gjykata ka pohuar se vendimi duhet të mbështetet vetëm mbi faktet që janë paraqitur gjatë procesit gjyqësor dhe duhet të përmbajë bazën ligjore mbi të cilën bazohet zgjidhja e mosmarrëveshjes, analizën e provave dhe mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes (*shih vendimin nr. 23, datë 29.04.2021 të Gjykatës Kushtetuese*). Arsyetimi duhet domosdoshmërisht të plotësojë kriteret minimale ligjore të përcaktuara dhe të mos ketë të meta të tilla serioze që cenojnë standardin e vendimit gjyqësor të arsyetuar (*shih vendimet nr. 8, datë 20.02.2024; nr. 19, datë 07.07.2022; nr. 55, datë 18.12.2012 të Gjykatës Kushtetuese*).

17. Lidhur me vendimet e dhëna nga Gjykata e Lartë në dhomën e këshillimit Gjykata ka theksuar se shqyrtimi i çështjes nga dhoma e këshillimit e Gjykatës së Lartë nuk është vetëm një konstatim formal i paraqitjes së shkaqeve ligjore në rekurs, por konsiston në vlerësimin e këtyre shkaqeve dhe bazueshmërisë së tyre, duke analizuar materialet e dosjes gjyqësore. Në rast se Kolegji në dhomën e këshillimit krijon bindjen se shkaqet e ngritura në rekurs janë haptazi të pabazuara, pasi nuk bëjnë pjesë në ato që parashikon dispozita ligjore ose nuk gjejnë mbështetje në aktet e dosjes gjyqësore, atëherë është në funksionin e tij të vendosë, në pajtim me kërkesat ligjore, mospranimin e çështjes për shqyrtim në seancë gjyqësore (*shih vendimet nr. 5, datë*

09.02.2023; nr. 9, datë 26.03.2018; nr. 12, datë 19.03.2015 të Gjykatës Kushtetuese). Arsyetimi i kufizuar i vendimeve të dhomës së këshillimit nuk përbën cenim të së drejtës për një proces të rregullt ligjor dhe se një arsyetim i tillë është tregues i faktit që kërkuesi nuk ka ngritur një nga argumentet ligjore të përcaktuara në dispozitën përkatëse të legjislacionit të brendshëm, që është kusht për pranimin e kërkesës (shih vendimet nr. 16, datë 16.03.2021; nr. 9, datë 26.03.2018; nr. 8, datë 26.02.2015 të Gjykatës Kushtetuese).

18. Nga ana tjetër, Gjykata, në jurisprudencën e saj ka theksuar se vlerësimi i provave dhe problemet e interpretimit dhe zbatimit të ligjit për zgjidhjen e çështjeve konkrete nuk përfshihen në juridiksionin kushtetues, nëse nuk shoqërohen me cenimin e të drejtave kushtetuese. Mënyra se si gjykatat e zakonshme kanë përcaktuar faktet dhe kanë interpretuar ligjin e zbatueshëm në zgjidhjen e mosmarrëveshjes në shqyrtim përpara tyre nuk përbën lëndë kushtetuese (shih vendimet nr. 38, datë 02.12.2021; nr. 6, datë 16.02.2021; nr. 9, datë 26.03.2018 të Gjykatës Kushtetuese). Po kështu, Gjykata ka pohuar se detyra e saj është të vlerësojë nëse gjatë procesit gjyqësor ka pasur shkelje të të drejtave kushtetuese, si dhe nëse zbatimi i ligjit ka qenë eventualisht arbitrarisht, në kuptimin që të bjerë ndesh haptazi me konceptin e gjykimit të drejtë të përcaktuar në nenin 42 të Kushtetutës (shih vendimet nr. 64, datë 01.10.2024; nr. 59, datë 14.11.2023; nr. 33, datë 14.11.2022 të Gjykatës Kushtetuese).

19. Duke iu kthyer rastit në shqyrtim, Kolegji konstaton se kërkuesi është proceduar penalisht si autor i dyshuar për veprën penale “Vrasja për shkak të marrëdhënieve familjare”, të kryer në bashkëpunim, të parashikuar nga nenet 79/c dhe 25 të KP-së, ndërsa më herët, për këtë veprë penale është proceduar penalisht dhe dërguar për gjykim bashkëshorti i viktimës. Kërkuesi është mbrojtur nga avokat të zgjedhur gjatë gjithë procesit penal. Çështja e tij është gjykuar me procedurë të zakonshme, veçmas dhe pas asaj në ngarkim të bashkëshortit të viktimës. Ai ka mbajtur qëndrim mohues ndaj akuzës. Në gjykim janë marrë provat e kërkuara nga organi i akuzës, të tilla, si: procesverbalet e këqyrjes së vendit të ngjarjes dhe të kufomës; akti i ekspertimit mjekoligjor i viktimës; akti i ekspertimit toksikologjikoligjor i viktimës; akti i ekspertimit biologjik krahasues të ADN-së së viktimës; procesverbalet e sekuestrimit të dokumenteve dhe akt ekspertimi grafik i shkrimit; procesverbalet e këqyrjes së aparateve të telefonave të viktimës dhe të bashkëshortit të saj; dy akte ekspertimi teknik telefonik të viktimës, procesverbali i transkriptimit të bisedave të regjistruara në aparatit telefonik të viktimës; tabulatet telefonike të viktimës dhe bashkëshortit të saj, prova këto të grumbulluara në kuadër të procedimit penal të parë ndaj

bashkëshortit të viktimës. Po me kërkesë të organit të akuzës, në gjykim janë marrë dhe procesverbali për marrjen e kampionit biologjik të pështymës së kërkuesit për kryerjen e ekspertimit biologjik të ADN-së dhe akti i ekspertimit biologjik krahasues i ADN-së së tij, të grumbulluara në kuadër të procedimit penal të kërkuesit. Po kështu, me kërkesë të organit të akuzës në gjykim janë marrë edhe prova me dëshmitarë (8 të tillë), ndërsa për 2 shtetas janë lexuar deklaratimet e tyre gjatë hetimeve paraprake, pasi ata nuk janë gjendur me gjithë kërkimet e bëra nga Policia Gjyqësore. Për provat e paraqitura nga organi i akuzës, kërkuesi dhe mbrojtësit e tij kanë pasur mundësi t'i debatonin dhe t'i kundërshtonin ato. Në këtë kuadër, me kërkesën e tyre, fillimisht, në gjykim janë dëgjuar bisedat e regjistruara në aparatën telefonik të viktimës dhe, në vijim, është marrë si provë një aktekspertimi audioteknik në lidhje me bisedat e regjistruara. Po kështu, në gjykim janë marrë edhe provat me dëshmitarë (2 të tillë) të kërkuara nga kërkuesi dhe mbrojtësit e tij, sikundër kërkuesi ka shfrytëzuar të drejtën për të dhënë deklaratime.

20. Gjatë gjykimit në gjykatën e shkallës së parë, Kolegji, gjithashtu, konstaton se mbrojtësit e kërkuesit kanë paraqitur disa kërkesa procedurale në lidhje me provat, të cilat janë marrë në shqyrtim nga gjykata. Konkretisht, gjykata ka rrëzuar kërkesën e tyre për pavlefshmërinë e procesverbalit të transkriptimit të bisedave të regjistruara në aparatën telefonik të viktimës, me arsyetimin se në rastin konkret nuk ndodhet para përgjimit në kuptim të neneve 221 e vijues të KPP-së, por përpara një regjistrimi privat. Gjkata ka rrëzuar edhe kërkesën për pavlefshmëri dhe papërdorshmëri të aktit të parë të ekspertimit teknik telefonik të viktimës, me arsyetimin se aparati telefonik është dorëzuar nga fëmija e viktimës dhe ai i është nënshtruar rregullisht ekspertimit, nga i cili nuk ka rezultuar ndërhyrje ose manipulim të regjistrimeve. Edhe kërkesa e tyre për pavlefshmëri dhe papërdorshmëri të aktit të ekspertimit biologjik krahasues të ADN-së së kërkuesit është rrëzuar nga gjykata me arsyetimin se është e vërtetë se viti (2017) i shënuar në aktin e ekspertimit është përpara se ai (viti 2018) i vendimit për kryerjen e ekspertimit, por se viti i shënuar në aktin e ekspertimit është një gabim material referuar përmbajtjes së vetë aktit që i referohet vendimit për kryerjen e ekspertimit dhe procesverbalit për marrjen e kampionit biologjik të pështymës së kërkuesit. Gjkata ka rrëzuar edhe kërkesën e tyre për kryerjen e riekspertimit biologjik krahasues të ADN-së së kërkuesit, me arsyetimin se organi procedues ka respektuar dispozitat procedurale në lidhje me marrjen e kampionit biologjik të pështymës së kërkuesit, ndërsa kampioni është marrë në prani të mbrojtësit gjatë procedimit penal, ashtu dhe për kryerjen e ekspertimit nga ekspertë të fushës, për të cilët nuk u paraqit asnjë e dhënë ose indicie për anësi,

manipulim të dhënash ose në lidhje me aftësitë e tyre profesionale. Për më tepër, kërkuesi dhe mbrojtësit e tij janë njohur me vendimin e ekspertimit dhe ekspertët e caktuar, duke mos paraqitur kundërshtime në lidhje me çështjet e ekspertimit dhe ekspertët, ndaj është e panevojshme kryerja e një ekspertimi tjetër. Gjykata e ka vlerësuar të pabazuar pretendimin e kërkuesit për sa i përket bashkimit të procedimit të tij me atë të bashkëshortit të viktimës, duke arsyetuar se një bashkim i tillë ka qenë i pamundur, pasi jo vetëm procedimet kanë filluar në kohë të ndryshme, por edhe çështjet nuk kanë qenë në të njëjtën gjendje dhe shkallë sepse në momentin kur çështja e kërkuesit ka kaluar për gjykim, çështja e bashkëshortit të viktimës kishte përfunduar së gjykuari në gjykatën e shkallës së parë.

21. Në lidhje me themelin e çështjes, Kolegji konstaton se gjykata e shkallës së parë, në vendimin e saj, ka arsyetuar se nga vlerësimi në tërësi dhe harmoni të provave të administruara në gjykim, provohej fakti se mes viktimës dhe bashkëshortit të saj, pas lindjes së fëmijës së tretë, kanë lindur mosmarrëveshje dhe grindje për motive xhelozie nga ana e bashkëshortit, i cili e akuzonte viktimën për tradhti bashkëshortore, çka provohej nga regjistrimet e bisedave në aparatën telefonik të viktimës, nga letrat e shkruara prej saj, por edhe nga dëshmitarët. Në një situatë të tillë, bashkëshorti i viktimës ka filluar të bëjë plane për eliminimin e saj me qëllim që ajo të mos përfitonte nga pasuria në rast divorci dhe, për këtë ka kërkuar ndihmën e kërkuesit, i cili punonte në biznesin e tyre dhe me të cilin kishte një marrëdhënie shoqërore që tejkalonte atë të punës. Nga bisedat e regjistruara në aparatën telefonik të viktimës del se ata kanë thurur disa plane, duke e vënë atë në gjendje hipnoze ose helmuar, por pa e arritur, ndërkohë që gjendja mes bashkëshortëve vijonte të rëndohej. Ditën e ngjarjes, ndërsa punëtorët kanë qenë pushim, rreth orës 08:10 bashkëshorti e ka çuar viktimën në mjediset e biznesit dhe është larguar duke bërë disa takime me qëllim krijimin e alibisë për atë që do të ndodhte më pas. Rreth orës 11:00 ai është kthyer në mjediset e biznesit nga ku ka njoftuar urgjencën mjekësore dhe motrën e viktimës, ndërsa kjo e fundit ka qenë e pajetë. Sipas ekspertimit mjeko-ligjor vdekja e saj duhet të ketë ndodhur në intervalin kohor 08:10 - 10:00, si pasojë e asfiksionit mekanik, nga shtrëngimi i qafës me duar dhe mjete të tjera rrethore ndihmëse. Në thonjtë e dorës së djathtë të viktimës janë gjetur mbetje humane, të cilat janë marrë me qëllim identifikimin e autorit të mundshëm të vrasjes përmes profilit gjenetik, profil ky që i krahasuar më pas me profilin gjenetik të kërkuesit, ka rezultuar i njëjtë. Nisur nga kjo, sipas gjykatës, mes kërkuesit dhe bashkëshortit të viktimës ka pasur një marrëveshje bashkëpunimi (*pactum seleris*) me qëllim vrasjen e viktimës, ku kërkuesi ka vepruar në rolin e

ekzekutorit, ndërsa bashkëshorti i saj në atë të organizatorit. Nga ana tjetër, ajo gjykatë ka marrë në analizë edhe provat me dëshmitarë të kërkuesit, ku për sa i përket bashkëshortes së tij ka vlerësuar se deklaratimet e saj merren me rezervë jo vetëm për shkak të interesit, por edhe se ajo nuk ishte e besueshme pasi, megjithëse mbante mend veprimet e bashkëshortit ditën e ngjarjes, nuk mbante mend detaje të rëndësishme të jetës së saj, dhe për më tepër deklaratimet e kësaj shtetaseje nuk përputheshin me asnjë provë tjetër. Kurse për sa i përket dëshmitarit I.D., gjykata ka evidentuar se ai nuk ka deklaruar asnjë të dhënë me interes për ditën e ngjarjes, referuar pretendimit të kërkuesit se është takuar me të ditën dhe në kohën e ngjarjes, në qendrën ku ai shtetas punonte.

22. Në vijim, gjykata e apelit me kërkesën e mbrojtësve të kërkuesit ka përsëritur pjesërisht shqyrtimin gjyqësor, duke marrë si provë aktin e ekspertimit të zërit (përfshirë dhe aktin shtesë), provë e cila ishte marrë gjatë gjykimit në apel të çështjes ndaj bashkëshortit të viktimës. Nga ana tjetër, me të njëjtin arsyetim si gjykata e shkallës së parë, ajo gjykatë ka rrëzuar kërkesën e tyre për riekspertimin biologjik krahasues të ADN-së së kërkuesit. Në përfundim të gjykimit, gjykata e apelit ka lënë në fuqi vendimin e gjykatës së shkallës së parë me të njëjtën linjë arsytimi si për sa i përket provueshmërisë së faktit penal, cilësimit juridik të veprës dhe fajësisë së kërkuesit. Ndërkohë, në përgjigje të pretendimeve të kërkuesit, ajo gjykatë ka theksuar se fajësia e tij nuk bazohej në një provë të vetme, por nga tërësia e provave të marra dhe të vlerësuara në gjykim. Sipas gjykatës së apelit, pretendimet e kërkuesit për proces të rregullt ligjor janë haptazi të pabazuara, duke vlerësuar se gjykata e shkallës së parë ka respektuar të drejtën e tij si i pandehur për të marrë dhe për të verifikuar çdo provë në ngarkim të tij, sikundër edhe të drejtën për të paraqitur prova, duke mos konstatuar asnjë shkelje ose dhunim të të drejtave dhe garancive procedurale. Po sipas saj, gjykimi në gjykatën e shkallës së parë është zhvilluar konform rregullave procedurale dhe nuk konstatohet të jetë cenuar parimi i barazisë së armëve, ndërsa çdo provë i është nënshtruar debatit gjyqësor pa iu dhënë asnjëherë prej tyre ndonjë vlerë e paracaktuar. Gjykata e shkallës së parë nuk ka pranuar ato prova që në vlerësim të saj kanë qenë të panevojshme. Në veçanti, gjykata e apelit ka arsyetuar se marrja e kampionit biologjik të pështymës së kërkuesit është bërë në përputhje me kërkesat e ligjit, nenit 201/a të KPP-së, ndërsa referuar akteve të fashikullit të gjykimit konstatohet se në të gjendet deklarata e tij, në prani të mbrojtësit të zgjedhur, ku shpreh pëlqimin për marrjen e kampionit biologjik me qëllim përcaktimin e profilit të ADN-së, si dhe procesverbali për marrjen e kampionit biologjik i shoqëruar me tabelën fotografike, çka

tregon se ky veprim është kryer me vullnetin e plotë të kërkuesit dhe në prani të mbrojtësit të zgjedhur prej tij.

23. Për rekursin e kërkuesit Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, në dhomën e këshillimit, ka vendosur mospranimin e tij, duke i vlerësuar si haptazi të papranueshme/të pabazuara shkaqet e ngritura në të, të cilat janë të njëjtat me pretendimet e tij në gjykatën e apelit. Sipas atij kolegji, gjykatat e faktit kanë arsyetuar mjaftueshëm lidhur me zbatimin e ligjit dhe se nuk konstatohet zbatim i gabuar i ligjit penal material ose procedural me rëndësi për njësimin ose zhvillimin e praktikës gjyqësore, nuk evidentohen shkaqe që lidhen me mosrespektimin ose zbatimin e gabuar të ligjit procedural me pasojë pavlefshmërinë e vendimit dhe pavlefshmërinë absolute të akteve ose papërdorshmërinë e provave, si dhe nuk evidentohet që vendimi i kundërshtuar të jetë në kundërshtim me praktikën e Kolegjit Penal ose të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë. Nga ana tjetër, sipas atij kolegji, pjesa e pretendimeve në recurs që ngre çështje të provave (të shqyrtuara nga gjykatat e faktit në zbatim të nenit 152 të KPP-së), del jashtë juridiksionit ekskluzivisht ligjor të Gjykatës së Lartë.

24. Për sa më lart, referuar argumenteve të paraqitura nga kërkuesi, Kolegji vëren se gjykatat e faktit i kanë krijuar atij të njëjtën mundësi, si dhe akuzës për të paraqitur çështjen, sikundër edhe për të paraqitur argumente e prova në mbrojtje të interesave të tij. Shqyrtimi i çështjes dhe nxjerrja e konkluzioneve nga gjykatat nuk është bërë vetëm mbi bazën e provave të paraqitura nga akuza, por, përkundrazi, kërkuesit i është dhënë mundësia të dëgjohet për faktet, provat dhe vlerësimet ligjore. Marrja e provave i është nënshtruar debatit real ndërmjet akuzës dhe mbrojtjes dhe procedurat lidhur me mënyrën se si janë siguruar rezultojnë në përputhje me ligjin procedural, ndaj, si të tilla, janë të drejta. Në këtë drejtim, ekspertimi biologjik krahasues i ADN-së së kërkuesit, i lidhur me të edhe marrja e kampionit biologjik të pështymës nga ai, sikurse gjykatat e zakonshme kanë arsyetuar, janë kryer në përputhje me ligjin procedural penal, duke mos u verifikuar shkelja e ndonjë ndalimi të parashikuar nga ligji. Nisur nga kjo, por edhe nga konstatimi i mungesës së justifikimeve të tjera referuar kërkesave të ligjit procedural penal, përfundimi i gjykatave të faktit për panevojshmërinë e riekspertimit biologjik krahasues të ADN-së së kërkuesit dhe rrëzimit për këtë shkak të kërkesës së mbrojtjes për marrjen e kësaj prove, nuk duket i paarsyeshëm. Ndërsa sa i përket mosveprimit të gjykatave të faktit për marrjen si provë të informacionit për vendndodhjen e qelizës telefonike të aparatit telefonik të kërkuesit dhe lëvizjet që ka bërë ditën e ngjarjes, konstatohet se mbrojtja e tij jo vetëm nuk ka paraqitur një kërkesë e

tillë, por as argumenton domosdoshmërinë për marrjen e këtij informacioni referuar atij numri telefonik të pretenduar në kontekst të bisedës së regjistruar mes tij dhe bashkëshortit të viktimës, nga e cila lihet të kuptohet se kërkuesi ka pasur në përdorim të paktën edhe një numër tjetër telefoni (shih paragrafin e fundit në faqen 44 të vendimit të GJKKO-së së Shkallës së Parë). Nga ana tjetër, gjykatat e faktit nuk iu kanë dhënë provave vlerë të paracaktuar, ndërsa ato janë vlerësuar në tërësi dhe harmoni me njëra-tjetrën.

25. Po kështu, Kolegji vëren se vendimet e gjykatave të faktit të kundërshtuara nga kërkuesi tregojnë mjaftueshëm rrethanat e çështjes, faktet e pranuar dhe përfundimet e nxjerra prej tyre, si dhe dispozitat ligjore në të cilat ato janë bazuar në zgjidhjen e çështjes në atë mënyrë. Ato gjykata kanë vlerësuar provat dhe pretendimet e palëve, përfshirë edhe ato të kërkuesit, dhe në analizë të tyre kanë zbatuar në vijim ligjin penal ndaj tij. Provat mbi të cilat gjykatat kanë mbështetur vendimin e tyre janë pikërisht ato që i janë nënshtruar shqyrtimit gjyqësor, ndaj ato nuk janë imagjinare ose jo në formën e kërkuar nga ligji. Po kështu, gjykatat në vendimet e tyre kanë përshkruar mekanizimin e ngjarjes dhe mënyrën e kryerjes së saj nga kërkuesi, pikërisht përmes shtrëngimit të qafës së viktimës me duar dhe mjete të tjera rrethanore ndihmëse. Gjykatat e faktit kanë arsyetuar mjaftueshëm për çdo veprim procedural të kryer, sikundër edhe për çdo kërkesë procedurale të kërkuesit. Nisur nga kjo, rezulton se gjykatat e zakonshme kanë përmbushur detyrimin për arsyetimin e vendimit të tyre, ndërkohë që interpretimi nga ato i ligjit, i shprehur përmes arsyetimit, nuk duket i paarsyeshëm ose arbitrар, për sa kohë nuk evidentohet ndonjë gabim ligjor ose faktik i dukshëm. Në këtë pikë, Kolegji vë në dukje se mënyra se si gjykatat e zakonshme kanë përcaktuar faktet dhe kanë interpretuar ligjin e zbatueshëm në zgjidhjen e mosmarrëveshjes në shqyrtim përpara tyre nuk përbën lëndë kushtetuese.

26. Në vlerësimin e Kolegjit edhe vendimi tjetër i kundërshtuar nga kërkuesi, ai i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, i marrë në dhomën e këshillimit, në funksion të shqyrtimit paraprak të rekursit, tregon vendimmarrjen e gjykatave më të ulëta, shkaqet e ngritura në rekurs, ligjin e zbatueshëm, si dhe pjesën arsyetuese ku mbështetet qëndrimi i shprehur në dispozitiv. Përmes parashtrimit të shkaqeve të rekursit në vendimin gjyqësor të kundërshtuar, sikundër edhe arsyetimit të kufizuar në lidhje me to, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë tregon se pasi i ka vlerësuar ato, ka arritur në përfundimin se rekursi i paraqitur nga kërkuesi është haptazi i pabazuar, sepse shkaqet e ngritura në të nuk gjejnë mbështetje në aktet e dosjes gjyqësore.

27. Për sa më lart, pretendimi i kërkuarit për cenimin e parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit i lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor, është haptazi i pabazuar.

28. Në përfundim, Kolegji çmon se kërkesa nuk plotëson kriteret ligjore për kalimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pikat 1 dhe 2, shkronja “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.